



SA E PULLES
LIKUJDUA

DËSHMI E TRASHËGIMISË LIGJORE

Sot, në datë **26.04.2019** (njëzet e gjashtë Prill dymijë e nëntëmbëdhjetë), unë, noteri Emil P. Barçi, me seli në qytetin e Elbasanit, lagja "Kongresi i Elbasanit", rruga "28 Nëntori", pall. 36, kt. 1, mora në shqyrtim kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga :

Kërkues : **Julian Skraqi**, atësia Zabit, i dtl. 10.12.1980, lindur dhe banues në Elbasan, me NID - **I01210173H**, pajisur me letërnjoftim nr. 028976860, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Objekti : Lëshim i dëshmisë së trashëgimisë ligjore për shtetasin **Zabit Skraqi**, atësia Sadik, mëmësia Selvie, i dtl. 27.04.1948, lindur në Fier Shegan, Lushnje, vdekur në datë 23.02.2019, në Elbasan, shtetësia shqiptare, me NID - E80427092I, gjendja civile "i martuar", duke përcaktuar trashëgimtarët ligjorë dhe pjesët e tyre takuese.

Baza ligjore : Nenet 316 e vijues, 348, 360 e vijues të Kodit Civil; Ligji nr.121, datë 18.04.2013; Ligji nr. 110/2018, datë 20.12.2018, "Për Noterinë", si dhe aktet e tjera nenligjore ne fuqi.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur nga kërkuesi :

KONSTATOJ :

- Sipas çertifikatës së vdekjes lëshuar nga z.gj.c. nr. 3, datë 12.04.2019, Bashkia Elbasan, rezulton se shtetasi **Zabit Sadik Skraqi**, me NID - **E80427092I**, ka vdekur në datë **23.02.2019**, me adresë të fundit banimi në qytetin e Elbasanit. Kërkuesi rezulton të jetë i biri i trashëgimlënësit. Pra legjitimohet kërkesa e bërë si dhe kompenteca vendore për lëshimin e kësaj dëshmie trashëgimie.
- Sipas çertifikatave të paraqitura nga kërkuesi, që vërtetojnë :
 - perbërjen familjare para vdekjes së tij, lëshuar z.gj.c. nr. 3, Bashkia Elbasan;
 - përbërjen e trungut familjar, regjistri nr.11/48, viti 1974, lagja "Partizani", Elbasan.
 - përbërjen e trungut familjar, fl.1/98, viti 1974, Fiershegan, Lushnje, gjendja vitit 1978;
 - përbërjen e trungut familjar, fl.1/31, viti 1974, Fiershegan, Lushnje;
 - përbërjen e trungut familjar viti 1950-1974, Fiershegan, Lushnje, Nenprefektura Lushnje;

rezulton se

- Trashëgimlënësi në kohën e vdekjes, ka qenë me gjendje civile "i martuar", me zj. **Hasije Skraqi**, atësia Sherif, mëmësia Kajaçe, e dtl. 01.09.1949, lindur në Barbullinj, Lushnje, me NID - **E95901191R**, mbiemri i vajzërisë "Sina". Vërtetohet lidhja e tyre martesore sipas çertifikatës së martesës lëshuar nga z.gj.c. Arkiva, Nenprefektura Lushnje, në bazë të aktit të martesës nr. 48, datë 19.10.1971. Në kohën e lidhjes së martesës, trashëgimlënësi rezulton me gjendje civile "beqar", pra nuk ka pasur lidhje të mëparshme martesore.

- Gjatë martesës së tyre ju kanë lindur tre fëmijë :

- **Artan Skraqi**, i dtl. 11.02.1973, lindur në Fiershegan, Lushnje, me NID - **H30211202H**.
- **Afrim Skraqi**, i dtl. 11.10.1974, lindur në Fiershegan, Lushnje, i cili ka vdekur datë 30.05.1990, me gjendje civile "beqar".

- Julian Skraqi, i dtl. 10.12.1980, lindur në Elbasan, me NID - **I01210173H**.

- Sipas deklarimit të kërkuesit, në dijeninë e tij, trashëgimlënësi nuk ka pasur fëmijë të tjerë të lindur jashtë martese, nuk ka përjashtuar ndonjë trashëgimtar ligjor, dhe se asnjë prej trashëgimtarëve ligjorë, nuk ka hequr dorë nga kjo trashëgimi. Nuk rezultojnë në ngarkim të trashëgimlënësit, persona të paaftë për punë.
- Nga kontrolli në Regjistrin Kombëtar të Testamentave, konfirmohet nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, se trashëgimlënësi **nuk ka lënë testament**.
- Meqenëse trashëgimlënësi ka vdekur më datë **23.02.2019**, në referim të nenit 317, të Kodit Civil në fuqi, **do të zbatohen dispozitat për trashëgiminë ligjore**. Përcaktimi i trashëgimtarëve ligjorë dhe pjesëve të tyre takuese në këtë trashëgimi, do të bëhet në referim të nenit 360 e vijues, të Kodi Civil të Republikës së Shqipërisë.
- Nga analiza e dokumentacionit dhe faktave të sipërcituara, si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë, do të thirren bashkëshortja dhe dy djemtë e tij që rezultojë të gjallë në kohën e vdekjes së tij, duke trashëguar në pjesë të barabarta midis tyre, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e rrjedhura nga kjo trashëgimi.

- Mbi bazën e konstatimeve të sipërpërmendura, vërej se kërkesa është e bazuar në ligj e në prova dhe si e tillë duhet pranuar. Për këto arsyё në bazë të dispozitave referuese të Kodit Civil dhe ligjit "Për Noterinë" në fuqi :

V E N D O S

Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për shtetasin **Zabit Skraqi**, atësia Sadik, mëmësia Selvie, i dtl. 27.04.1948, lindur në Fier Shegan, Lushnje, vdekur në datë 23.02.2019, në qytetin e Elbasanit, shtetësia shqiptare, me NID - E80427092I, gjendja civile "i martuar", duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjore të radhës së parë :

- 1) - bashkëshorten **Hasije Skraqi**, atësia Sherif, e dtl. 01.09.1949, lindur në Barbullinj, Lushnje, gjendja civile "e ve", shtetësia shqiptare, me NID - **E95901191R**.
- 2) - të birin **Artan Skraqi**, i dtl. 11.02.1973, lindur në Fiershegan, Lushnje, me shtetësi shqiptare, me NID - **H30211202H** gjendja civile "i martuar".
- 3) - të birin **Julian Skraqi**, i dtl. 10.12.1980, lindur në Elbasan, me shtetësi shqiptare, me NID - **I90214021A**, gjendja civile "i martuar".

të cilët trashëgojnë, në pjesë të barabarta, nga **1/3 pjesë takuese sejcili**, të drejtave dhe detyrimeve të rrjedhura nga kjo trashëgimi.

Ky akt notarial u redaktua në gjashtë kopje të njëjta. Bashkangjitur aktit janë çertifikatat lëshuara nga z.gj.c. dhe konfirmimi i marrë nga Dhoma Kombëtare e Noterisë.

Kërkuesi u bë me dije për detyrimin e regjistrimit të këtij vendimi, brenda afatit 30 ditor, pranë çdo Z.V.R.P.Paluajtshme, pasi me kalimin e këtij afati, aplikohet gjobë, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", e akteve të tjera nënligjore.

Noter

EMIL P. BARÇI

